

Qershor 2024 | Nr. 39

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
@ILD\_Albania

### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË ZYRTARE TEK HOMOLOGU FRANCEZ









rëndësinë e rolit të institucioneve që drejtojnë, sa i takon pavarësisë në punë dhe ndikimit në sistem, në forcimin e standardeve më të mira profesionale e të etikës sëmagjistratëve, si një kontribut real për forcimin e besimit të qytetarëve tek drejtësia dhe shteti i së drejtës.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një

takim pune me prokurorin e përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë, z. Remy Heitz, i cili e njohu z. Metani me ndryshimet kushtetuese të vitit të kaluar në Francë, edhe në rolin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vendimmarrjen në procedimin disiplinor, në cilësinë e tij si kryetar i këtij Këshilli për prokurorët, e më tej për çështje të deontologjisë, në kuadër të funksionit të tij si zëvendës kryetar





i bordit të Shkollës franceze të Magjistra-turës.

Në takimin me gjyqtaren Valérie Delnaud,

që drejton kabinetin e Ministrit të Drejtësisë, u fol për sfidat e ngjashme të sistemit të drejtësisë në Francë dhe

Shqipëri, si dhe eksperiencën franceze, që fokusohet tek procesi para-disiplinor, pra parandalimi, para sanksionimit disiplinor të

magjistratëve.

Në funksion të kësaj qasje, Ministria e Drejtësisë ka ngritur Kolegjin e Deontologjisë, që përbëhet nga








personalitete jo vetëm të drejtësisë, nën drejtimin e një veterani të sistemit, inspektorati francez të drejtësisë, me të cilin z.Metani u ndal në çështje të etikës e deontologjisë së magjistratëve. Çështje të deontologjisë së magjistratëve por edhe shkëmbimi i eksperiencave profe-

sionale ishin në qendër të takimit që In-drejtimit e një veterani të sistemit, spektori i Lartë i Drejtësisë pati me drejtor-magjistrati François Feltz, ish drejtues i In-spektoratit francez të drejtësisë, me të cilin z.Metani u ndal në çështje të etikës e de-ontologjisë së magjistratëve. këpunimit me Shkollën shqiptare të Magjistraturës.





### **NJË EKIP I ILD-SË, SHKËMBIM PROFESIONAL PUNE NË INSPEKTORATIN FRANCEZ**

Paris, 21 qershor 2024

Një ekip i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i përbërë nga inspektorë, ndihmës inspektorë dhe anëtarë të kabinetit, zhvilloi një vizitë studimore 5 ditore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, në Paris, me mbështetjen e Expertise France dhe EU4Justice. Në nisje të vizitës ekipi i ILD-së u mikprit nga Shefi i Inspektoratit të Përgjithshëm të

Drejtësisë, z. Christophe Straudo, i cili bëri një paraqitje të funksioneve të ndryshme të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë. Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë, delegacioni i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi sesione pune me ekipin e Departamentit të Etikës. Drejtuesja e departamentit znj. Béatrice Del Volgo dhe inspektorët e këtij de-

*Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë, delegacioni i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi sesione pune me ekipin e Departamentit të Etikës.*





partamenti, znj. Marjorie Obadia dhe z. Ludovic Belfanti zhvilluan sesione prezantimi mbi etikën dhe procedurën para-disiplinore të magjistratëve, si dhe hetimet administrative, metodologjia, të drejtat e mbrojtjes, teknikat e objektivizimit, që u pasuan me diskutime profesionale me ekipin e ILD-së. Ekipi i ILD-së pati një sesion pune në Gjykatën e Parisit, ku u prit nga kryetari i

kësaj Gjykate z. Stéphane Noël dhe drejtuesja e Prokurorisë pranë kësaj Gjykate znj. Laure Beccau, të cilët paraqitën organizimin dhe funksionimin e gjykatës dhe prokurorisë, si dhe u ndalën në çështje të etikës së magjistratëve, me fokus rolin e drejtuesit të gjykatës dhe prokurorisë.





Më tej, ekipi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi një sesion pune me Kryetarin e Kolegjit të Etikës të Ministrisë së Drejtësisë, z. François Feltz, i cili paraqiti rolin dhe kushtet e krijimit të strukturës së Kolegjit të Etikës, organizimin dhe mënyrat e funksionimit të kësaj strukture.

Gjatë një vizite në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Paris, delegacioni i ILD-së u mikprit nga drejtorja e shkollës znj. Nathalie Roret, ndërsa më pas, ekipi i trajnimeve dhe i marrëdhënieve me jashtë, i njohu me funksionet e shkollës me vëmendje tek aktivitetet trajnuese të magjistratëve në fushën e etikës.







Procedura disiplinore e magistratëve iu paraqit delegacionit të ILD-së në një sesion të veçantë pune nga znj. Soizic Guillaume, zv. Drejtore e Burimeve Njerëzore për gjyqësorin, pasuar me diskutime mbi eksperiencën konkrete pune.

Kjo vizitë studimore e ekipit të ILD-së për

t'u njohur me praktikën franceze, vjen në kuadër të shkëmbimeve profesionale mes dy institucioneve të inspektimit, nisur me vizita trajnuese të inspektorëve francezë në Tiranë në vitin 2021 dhe vitin 2023. Vizita u realizua me mbështetjen e Expertise France dhe EU4Justice.





### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, I FTUARI I “IDM MORNING BRIEFING”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Meonesh, deputetë të Kuvendit, përfaqësues tani ishte i ftuari i takimit të katërt të “IDM të shoqërisë civile, të medias, akademikë e Morning Briefing”, një forum komunikimi i shkollarë etj, mbi çështje të interesit publik organizuar nga Instituti për Demokraci e institucional. Ndërmjetësim, që synon nxitjen e një diskutimi të hapur me titullarë instituci-







Takimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë përgjegjës për shkeljet e gjyqtarëve dhe i shërbeu nxitjes së një diskutimi bazuar në prokurorëve, menaxhimin e ankesave, evidenca, mbi cilësinë e Drejtësisë në nismën parlamentare për thellimin e përgjithësi, e me përfundimin e procesit të reformave, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionit, sfidat e ILD, si institucioni rupsionin, çështje të pavarësisë e ndarjes





së pushteteve, si dhe perspektivat për të ardhmen në kontekstin aktual të reformës në drejtësi në Shqipëri.

Diskutimet u fokusuan edhe në trajtimin e problematikave aktuale të sistemit,

rëndësinë jetike të bashkëpunimit mes institucioneve, për të arritur objektivin kryesor për të cilin u konceptua Reforma në Drejtësi, një sistem drejtësie i pavarur nga çdo lloj ndikimi dhe efektiv për të gjithë qytetarët.







*Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani ishte i ftuari i takimit të katërt të “IDM Morning Briefing”, një forum komunikimi i organizuar nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim, që synon nxitjen e një diskutimi të hapur me titullarë institucionesh, deputetë të Kuvendit, përfaqësues të shoqërisë civile, të medias, akademikë e shkollarë etj, mbi çështje të interesit publik e institucional.*





FOTO NGA AKTIVITETI







**INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË**



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KONFIRMON VEPRIMTARINË ORGANIZATIVE DHE FINANCIARE TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar auditimin financiar të ushtruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 3 vjeçare të punës, nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2023, me vlerësim pozitiv për performancën e institucionit në zbatim të ligjit, planifikimit dhe menaxhimit financiar.

Në çështjet e identifikuara nga ekipi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) ishin: Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit, Auditimi i llogarive vjetore, Vlerësimi i funksionimit të

sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në raportin përfundimtar të auditimit, vlerësohet se “Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Zyrës së ILD-së paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe

*Kontrulli i Lartë i Shtetit ka përfunduar auditimin financiar të ushtruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 3 vjeçare të punës, nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2023, me vlerësim pozitiv për performancën e institucionit në zbatim të ligjit, planifikimit dhe menaxhimit financiar.*

Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj. mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare që justifikojnë dhënien e një opinioni të pakualifikuar/pamodifikuar.”

Auditimi i KLSH-së përfshiu veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë edhe me aktet ligjore e nënligjore, si dhe në drejtim të:

- Zbatimi i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre
- Planifikimi i buxhetit, zbatimi i kriterëve në planifikimin e tij, realizimi i planit të buxhetit, si edhe shpenzimet adminis-

trative

- Zbatimi i dispozitave ligjore për strukturën organizative të Institucionit
- Zbatimi i dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe rakordimi i tyre, opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2022
- Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Raporti përfundimtar i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ushtruar në Zyrën e ILD-së mund të lexohet këtu: [RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT](#)

*Në çështjet e identifikuar nga ekipi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) ishin: Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit, Auditimi i llogarive vjetore, Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.*



## QERSHORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Qershor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **97 ankesa**, 93 nga të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe 4 ankesa nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit qershor 2024.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p><b>61 vendime nga 108 praktika të shqyrtuara konkretisht:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 50 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;</li><li>- 11 vendime arkivimi pas verifikimit;</li></ul>	<p><b>18 vendime verifikimi</b></p>	<p><b>1 vendim fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat gjyqtar</b></p>

## ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- \* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- \* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


\* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si pranohen ankesat”.

## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Qershor 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **13 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.








### ***Gjatë asistimit të ankuesve***

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



***Gjatë muajit Qershor 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 30 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 23 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.***



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit [amanta.jasa@ild.al](mailto:amanta.jasa@ild.al).

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve,

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Qershor 2024**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **7 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).



ILD NË TWITTER

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

#ILD iu nënshtrua për herë të parë auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për një periudhë 3 vjeçare. Gjetjet dhe raporti  
#transparencë #ILD

Translate post



From Ild.al

1:13 PM - 4.6.24 From Earth · 127 Views

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Vizitë pune e ekipit të ILD në Gjykatën e Parisit. Kryetari i Gjykatës #StéphaneNoël & prokurorja #LaureBeccuau folën për juridiksionin e gjykatës, rolin e drejtuesve me fokus etikën e magistratëve. #ILD  
#Vizitëpune #InspektoratiFrancez #ExpertiseFrance #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Kënaqësi personale e profesionale të takoj homologun, shefin e Inspektimit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës #ChristopheStraudo, mik i çmuar i Shqipërisë dhe ILD-së. Mirënjohës për angazhimin e tij për këtë shkëmbim profesional me ekipin e #ILD #IGJ #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Një shkëmbim shumë profesional pikëpikë me zotëtarin #ValérieDelmasud, që drejton kabinetin e Ministrisë së Drejtësisë. Folëm për shtat e njohjeve të drejtësisë në Francë dhe eksperiencën franceze që synon parandalimin, para sanksionimit disiplinor të magistratëve.



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Në mbyllje të vizitës studimore të një ekipi të ILD-së, mirënjohja ishte për mikpritësin, shefin e inspektoratit #ChristopheStraudo & ekipin e tij për organizimin e shkëlqyer dhe #AxeIGamet e ekipin e tij në #ExpertiseFrance për mbështetjen, falenderime edhe për EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Sektori ynë i ankesave dhe marrëdhënieve me publikun pret qytetarë çdo ditë javë nga ora 09.00-14.00 pranë ambienteve të #ILD-së. Si mund të ankojmë në ILD? Janë disa mënyra, fizikisht ose online e me postë. Për më shumë  
ild.al/sq/pyetje-te-s...

Translate post

Pasditë pune e ekipit të ILD në IPD me inspektorët e departamentit të etikës, për t'u njohur e diskutuar mbi etikën dhe procedurën para-disiplinore të magistratëve dhe hetimet administrative. #BéatriceDelVolgo #MarjorieObadia #LudovicBelfanti #ExpertiseFrance #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Kënaqësi e vecantë diskutimi profesional me një personalitet të drejtësisë franceze #FrancoisFeitz, ish drejtues i Inspektimit të Përgjithshëm të Drejtësisë, aktualisht kryetari i Kolegjit të Deontologjisë së Ministrisë së Drejtësisë. #ILD #ExpertiseFrance #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Kënaqësi e vecantë takimi & mbledhja e gjatë me Prokurorin e Përgjithshëm të Francës #RemyHeitz, njohësisht kryetari i Keshillit të Lartë të Drejtësisë për prokurorët Magjistër në bashkëpunim me organizimin, parimi i ndarjes së pushteteve & pavarësisë së magistratëve mbetet i njëjtë.



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

A team of the HU Office, consisting of inspectors, assistant inspectors and members of the cabinet, conducted a 5-day study visit to the General Inspection of Justice of France, with the support of Expertise France and EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Një ekip i ILD nisi vizitë studimore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë (IPD) së Mikpritja dhe paraqitja e institucionit nga shefi i IPD, z. Christophe Straudo & ekipi francez. Me mbështetjen e #ExpertiseFrance #EU4Justice

Translate post

Në Shkollën Kombëtare të Magistraturës në Paris me mikpritjen e drejtores #NathalieRoret dhe ekipit të Marrëdhënieve me Jashtë, që paraqitën edhe modul të trajnimit të shkollës në fushën e etikës & disiplinës #ILD #InspektoratiFrancez #ExpertiseFrance #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Takim frytdhënës me drejtoresh e Shkollës Kombëtare të Magistraturës në Paris #NathalieRoret, që ndau lajmin e shkëlqyer të zyrtarizimit të shpejtë të bashkëpunimit me Shkollën të Magistraturës. Eksperienca e çmuar për Shqipërisë #ILD #IGJ #ExpertiseFrance #EU4Justice



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Seslon teknik i procedimit disiplinor të magistratëve në Francë nga përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, e ngarkuar me këtë proces znj. Soizic Guillaume. #ILD #InspektoratiFrancez #ExpertiseFrance #EU4Justice



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted  
IDM Albania @IDM\_Albania · 2d  
IDM is pleased to announce the upcoming meeting of 'IDM Morning Briefing' with the participation of the High Inspector of Justice of Albania (HU), Mr. Artur Metani, @ILD\_Albania  
Supported by Hanns Seidel Foundation Albania.







## INSPEKTORËT E ILD-SË, TRAJNIM TEORIK DHE PRAKTIK MBI INSPEKTIMET TEMATIKE

Tiranë, 3 qershor 2024

Metodologjia e përgatitjes, kryerjes dhe analiza e inspektimeve klasike tematike ishin në fokus të aktivitetit trajnues 5 ditor, që u zhvillua në Tiranë dhe Durrës, me pjesëmarrjen e njësisë së inspektorëve dhe njësisë së ndihmës inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Aktiviteti i organizuar me kontributin e përbashkët të SEJIV (projekti i BE dhe KiE “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri”) dhe EU4Justice, i shërbeu, siç theksoi Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani në përshëndetjen e tij, traditës së krijuar tashmë të Zyrës së ILD-së, për forcimin sistematik të kapaciteteve të inspektorëve dhe ndihmës







inspektorëve, në rastin konkret, në kryerjen e inspektimit tematik klasik, bazuar në praktikat dhe standardet më të mira të BE-së.

Ne dy ditët e para, inspektorët dhe ndihmës inspektorët e ILD-së u trajnuan mbi metodologjinë e organizimit të inspektimeve tematike, në punën e brendshme të gjykatave dhe prokurorive, me përvojat franceze dhe

rumune, të përcjella nga z. Vincent Delbos, ish inspektor magjistrat i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës dhe znj. Nicoleta Rhfir, ish inspektore magjistrate e Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë.

Ekipet e inspektimit të ILD-së diskutuan edhe mbi përcaktimin e standardeve të inspektimeve, me referencë praktikën e





CEPEJ, Komisioni Europian për Efijencën e Drejtësisë.

Në dy ditët vijuese, dy ekipe inspektorësh të ILD-së, bashkë me ekspertët ndërkombëtarë zhvilluan një mision inspektues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës, të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas kalendarit vjetor të in-

spektimeve të ILD-së. Java e trajnimit u përmbyll në Tiranë, me një sesion të posaçëm me njësinë e inspektorëve e ndihmës inspektorëve, ku u diskutuan rezultatet kryesore, gjetjet e rekomandimet, në bazë të të cilave do të përgatitet një Udhëzues i praktikave më të mira të inspektimit.





**QERSHOR 2024**

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

**WEB:** [ild.al](http://ild.al)  
**EMAIL:** [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
**ADRESA:** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)*

